Udhëzues mbi përfitimet e pensioneve italiane 2025

Pensioni i pleqërisë (Pensione di vecchiaia)

Pensioni i pleqërisë është një përfitim ekonomik që jepet, me kërkesë të personit të interesuar, në favor të atyre punonjësve që i plotësojnë kushtet e moshës dhe të kontributeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Ky përfitim u drejtohet personave të regjistruar në Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm (duke përfshirë punonjësit e sektorit privat dhe skemat e posaçme për punonjësit e pavarur si artizanë, tregtarë, fermerë të drejtpërdrejtë, bujq dhe kolonë), në Fondin e Veçantë të Sigurimit, si dhe punonjësve që janë pjesë e skemave pensionale zëvendësuese ose ekskluzive të Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm.

Data e fillimit të pensionit ndryshon në varësi të skemës së përkatësisë.

Për **punonjësit e punësuar dhe të vetëpunësuar** të regjistruar në Sigurimin e Përgjithshëm të Detyrueshëm, si dhe për ata që janë të regjistruar në Skemën e Veçantë, pensioni i pleqërisë fillon nga dita e parë e muajit pas plotësimit të kushteve të nevojshme ose, me kërkesë të të interesuarit, nga muaji pas dorëzimit të kërkesës.

Për **punonjësit publikë** të regjistruar në skemat ekskluzive të Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm, pensioni fillon ditën pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Për personelin arsimor dhe për ata të Arsimit të Lartë Artistik, Muzikor dhe Koreografik (AFAM), data e fillimit është përkatësisht 1 shtatori dhe 1 nëntori i vitit kur rezultojnë të plotësuara kushtet.

Kushtet për të përfituar pensionin ndryshojnë në varësi të periudhës kohore të kontributeve të paguara nga i siguruari. Personat që zotërojnë kontribute përpara datës 1 janar 1996 përfshihen në **sistemin e llogaritjes së përzier** dhe mund ta përfitojnë pensionin të paktën **në moshën 67 vjeç** (kusht që mund të rishikohet sipas jetëgjatësisë duke filluar që nga viti 2027), si edhe me të paktën **20** vjet kontribute të vlefshme.

Punonjësit që kanë filluar të derdhin kontributet vetëm pas 1 janarit 1996 dhe që janë subjekt i **regjimit të pastër kontributiv**, mund të përfitojnë pension pleqërie në moshën 67 vjeç dhe me të paktën 20 vjet kontribute, me kusht që shuma e përfituar të jetë e barabartë ose më e madhe se ndihma sociale (e ashtuquajtura shumë minimale). Si alternativë, njihet mundësia për të përfituar të drejtën e pensionit në moshën 71 vjeç (me rregullim të mundshëm sipas jetëgjatësisë nga viti 2027), me të paktën pesë vjet kontribute efektive, pavarësisht nga shuma e përfituar.

Për qëllimet e njohjes së të drejtës për pension pleqërie, është e nevojshme që i siguruari të ketë ndërprerë marrëdhënien e punës si i punësuar. Nuk kërkohet ndërprerja e veprimtarisë për ata që veprojnë si të vetëpunësuar ose punonjës të punësuar në mënyrë të pjesshme.

Kërkesa për të përfituar pensionin mund të paraqitet **nëpërmjet kanaleve elektronike** të ofruara nga Instituti (portali i Institutit Kombëtar të Mbrojtjes Shoqërore - INPS), me anën e Qendrës së Kontaktit, ose duke përfituar ndihmën e institucioneve të patronateve dhe ndërmjetësve të autorizuar.

Pensioni i parakohshëm (Pensione anticipata)

Pensioni i parakohshëm është një përfitim pensioni që u njihet punonjësve që kanë përmbushur disa kushte të caktuara kontributesh, duke u lejuar atyre që të fitojnë të drejtën për pension përpara arritjes së moshës së parashikuar zakonisht për pensionin e pleqërisë.

Ky institut u drejtohet të regjistruarve në Sigurimin e Përgjithshëm të Detyrueshëm (që përfshin Fondin e Pensioneve për Punonjësit e Punësuar dhe skemat e veçanta për të vetëpunësuarit), në Fondin e Veçantë të Sigurimit, si edhe skemat zëvendësuese dhe ato ekskluzive të Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm.

Data e fillimit të pensionit të parakohshëm përcaktohet në bazë të kategorisë së përkatësisë.

Për punonjësit e sektorit privat, si edhe për të vetëpunësuarit, përfitimi fillon nga dita e parë e muajit mbas paraqitjes së kërkesës.

Për punonjësit e sektorit publik të regjistruar në skemat ekskluzive, pensioni fillon nga dita pas ndërprerjes së shërbimit.

Për personelin arsimor dhe atë të sektorit të Arsimi të Lartë Artistik, Muzikor dhe Koreografik, përfitimi i parakohshëm fillon përkatësisht më 1 shtator dhe më 1 nëntor të vitit kur rezultojnë të plotësuara kushtet.

Fillimi i përfitimit është i kushtëzuar nga një periudhë pritjeje tre mujore. Gjithashtu, data të ndryshme fillimi parashikohen sipas ligjit të buxhetit për vitin 2024, për të regjistruarit në disa arka të fondit ekskluziv, me periudha pritjeje që shtrihen progresivisht deri në nëntë muaj për përfitimet që nisin nga viti 2028. Këto dispozita nuk zbatohen në rastin e daljes në pension nëpërmjet bashkimit të periudhave të sigurimit, për të cilat fillimi përcaktohet në ditën e parë të muajit mbas paraqitjes së kërkesës.

Për të regjistruarit në Institutin Kombëtar të Mbrojtjes Shoqërore (INPS), mbas hyrjes në fuqi të dekretligjit nr. 4, të datës 28 janar 2019, e drejta për pension të parakohshëm lind mbas kalimit të një periudhe tremujore nga data e përmbushjes së kushteve (e ashtuquajtura **“dritare”**), ndërsa për të regjistruarit në disa arka të fondit ekskluziv, janë parashikuar periudha të ndryshme që shkojnë nga 4 deri në 9 muaj, në varësi të vitit të përmbushjes së kushteve (nga viti 2025 deri në vitin 2028). Për këta të fundit, këto periudha nuk zbatohen në rastin e bashkimit të periudhave të sigurimit; në këto raste, fillimi është caktuar nga dita e parë e muajit mbas dorëzimit të kërkesës, me kusht që të kenë kaluar tre muaj që nga përmbushja e kushteve.

E drejta për pension të parakohshëm është e kushtëzuar nga përmbushja e disa kritereve, të cilat ndryshojnë në varësi të kohës kur e kanë filluar derdhjen e kontributeve. Personat që e kanë filluar derdhjen e kontributeve para datës 1 janar 1996 mund ta përfitojnë pensionin e parakohshëm mbasi të kenë përmbushur 41 vjet e 10 muaj (2.175 javë) për gratë dhe 42 vjet e 10 muaj (2.227 javë) për burrat. Këto kushte janë të vlefshme deri më 31 dhjetor 2026. Kërkohet, gjithashtu, që të zotërohen njëkohësisht të paktën 35 vjet kontribute të vlefshme për qëllimin e përfitimit, duke përjashtuar periudhat e sëmundjes, papunësisë dhe përfitimeve të barasvlefshme, në qoftë se pensioni është likuiduar nga ana e Fondit të Pensioneve të Punonjësve në Vartësi (FPLD).

Për ata persona, të cilëve derdhja e kontributeve të para u është regjistruar mbas datës 1 janar 1996, pra që futen në sistemin kontributiv të pastër, përfitimi mund të merret me të njëjtat kushte si më sipër (**41 vjet e 10 muaj** për gratë, **42 vjet e 10 muaj** për burrat), duke përjashtuar kontributet vullnetare. Për periudhat e punës përpara mbushjes së moshës 18 vjeç, kontributet shumëzohen me një koeficient prej 1.5.

Si alternativë, punonjësit me regjim kontributiv të pastër mund të përfitojnë pension të parakohshëm kur mbushin moshën 64 vjeç, me kusht që të kenë të paktën 20 vjet kontribute efektive (duke përjashtuar kontributet që u njihen për periudha të vecanta) dhe që shuma e këstit të parë të pensionit të rezultojë të jetë të paktën sa trefishi i shumës mujore të ndihmës sociale. Ky prag ulet në 2.8 herë për gratë me një fëmijë dhe në 2.6 herë për gratë me të paktën dy fëmijë. Edhe në këtë rast, e drejta për përfitim lind mbas tre muajsh nga përmbushja e kushteve.

Sqarohet se, deri në përmbushjen e kushteve për pensionin e pleqërisë, shuma mujore e pensionit të parakohshëm kontributiv nuk mund ta kalojë pesëfishin e shumës minimale të parashikuar për vitin e referimit (që për vitin 2024 është e barabartë me 2.993,05 euro).

Njohja e pensionit të parakohshëm i nënshtrohet ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Ndërsa në rastin e vetëpunësimit nuk kërkohet ndërprerja e veprimtarisë.

Kërkesa mund të dorëzohet elektronikisht nëpërmjet shërbimeve online të Institutit Kombëtar të Mbrojtjes Shoqërore (INPS), nëpërmjet Qendrës së Kontaktit ose nëpërmjet zyrave të patronateve dhe ndërmjetësve të autorizuar.

Pensioni i paaftësisë për punë (Pensione di inabilità)

Pensioni i paaftësisë për punë është një përfitim ekonomik që u njihet, mbas paraqitjes së një kërkese të posaçme, punonjësve, punonjësve të vetëpunësuar dhe personave të regjistruar në Fondin e Veçantë të Sigurimit për të cilët është konstatuar, nga ana e Komisionit Mjekësor Ligjor të Institutit, pamundësia absolute dhe e përhershme për të kryer ndonjë veprimtari pune, për shkak të sëmundjes apo të metave fizike ose mendore.

Duke filluar nga viti 2013, pensioni në fjalë paguhet duke marrë parasysh të gjithë kontributet që zotëron punonjësi në kuadrin e Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm (AGO), si edhe

në skemat zëvendësuese, përveç Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm dhe në Fondin e Veçantë të Sigurimit.

Data e fillimit të përfitimit caktohet dita e parë e muajit mbas të cilit paraqitet kërkesa, me kusht që në të njëjtën datë të rezultojnë të përmbushura të gjitha kërkesat shëndetësore dhe administrative. Përfitimi mund t'i nënshtrohet një rishikimi të mëvonshëm.

Shuma e pensionit përcaktohet me sistemin e përzier (mbi bazën e pagës ose kontributeve) ose ekskluzivisht me sistemin kontributiv për ata persona, për të cilët derdhja e parë e kontributeve është kryer mbas 31 dhjetorit 1995. Në bazë të legjislacionit në fuqi, vjetërsia kontributive e akumuluar rritet, deri në një maksimum prej 2080 javësh, me numrin e javëve midis fillimit të pensionit dhe mbushjes së moshës gjashtëdhjetë vjece, si për burrat ashtu edhe për gratë, mbas futjes së sistemit kontributiv për vjetërsinë e akumuluar nga data 1 janar 2012.

Përfituesit e një pensioni paaftësie për punë që nuk janë në gjendje të ecin pa ndihmë të vazhdueshme ose që nuk janë në gjendje të kryejnë në mënyrë të pavarur veprimtaritë e përditshme, mund të kërkojnë pagesën për ndihmë personale dhe të vazhdueshme. Kjo pagesë nuk paguhet në rastet e shtrimit në institucione publike që janë tërësisht në ngarkesë të administratës publike, nuk është e pajtueshme me trajtime të ngjashme INAIL dhe nuk u paguhet të pasjetuarve. Gjithashtu, në qoftë se personi merr një përfitim të ngjashëm nga forma të tjera të detyrueshme të sigurimeve shoqërore ose ndihmës, pagesa i jepet në një masë të reduktuar për shumën e tepërt.

Legjislacioni parashikon gjithashtu njohjen e pensionit të privilegjuar të paaftësisë, ekskluzivisht në favor të të regjistruarve në Sigurimin e Përgjithshëm të Detyrueshëm për punonjësit e punësuar, në rastet kur konstatohet ekzistenca e një lidhjeje të drejtpërdrejtë shkakësore midis sëmundjes dhe shërbimit të kryer gjatë një marrëdhënieje pune që i nënshtrohet detyrimit të sigurimit për Pensionin e Invaliditetit, Pleqërisë dhe atë Familjar (IVS). E drejta për këtë përfitim nuk mund të njihet në qoftë se nga ngjarja që ka shkaktuar paaftësinë të burojë e drejta për një pension INAIL ose për përfitime të vazhdueshme të sigurimeve shoqërore ose ndihmëse, në ngarkim të Shtetit ose të organeve të tjera publike.

Për të përfituar nga pensioni i paaftësisë për punë, është e nevojshme, përveç njohjes mjeko-ligjore të paaftësisë absolute dhe të përhershme për punë, të jenë grumbulluar të paktën 260 javë me kontribute (të barabarta me pesë vjet), nga të cilat të paktën 156 (tre vjet) në periudhën pesëvjeçare që i paraprin datës së paraqitjes së kërkesës. Gjithashtu, kërkohet ndërprerja e të gjithë veprimtarisë së punës, çregjistrimi nga regjistrat e punonjësve të bujqësisë dhe nga ato që lidhen me kategoritë e punonjësve të vetëpunësuar, çregjistrimi nga regjistrat profesionalë, si edhe heqja dorë nga përfitimet e paguara nga sigurimi i papunësisë dhe çdo trajtim plotësues ose zëvendësues i shpërblimit.

- **Pagesa e zakonshme e paaftësisë për punë(Assegno ordinario di invalidità)**

Pagesa e Zakonshme e Paaftësisë për Punë është një përfitim financiar, që paguhet me kërkesë, në favor të atyre personave, aftësia për punë e të cilëve është reduktuar në më pak se një të tretën për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore.

Instituti Kombëtar i Mbrojtjes Shoqërore (INPS), e jep këtë pagesë të zakoshme të paaftësisë për punë për punonjësit e mëposhtëm:

- të punësuarit e regjistruar në Sigurimin e Përgjithshëm të Detyrueshëm;
- të vetëpunësuarit (zanatçinj, tregtarë, bujq, kolonë dhe punëtorë bujqësie);
- të regjistruarit në Fondin e Veçantë të Sigurimit.

Pagesa e zakonshme e paaftësisë për punë fillon nga dita e parë e muajit mbas atij kur është paraqitur kërkesa, në qoftë se janë plotësuar të gjitha kushtet, si ato shëndetësore, ashtu edhe administrative, dhe ka një **vlefshmëri trevjeçare**.

Përfituesi mund të kërkojë konfirmimin në periudhën gjashtëmujore që i paraprin datës së përfundimit, pa ndërprerje të pagesës ose brenda 120 ditëve nga data e përfundimit. Mbas tri njohjeve të njëpasnjëshme, Pagesa e Invaliditetit konfirmohet automatikisht, përvec të drejtave të rishikimit.

Dhënia e Pagesës është e pajtueshme me kryerjen e veprimtarisë së punës, por është në shumë të reduktuar.

Me arritjen e moshës së daljes në pension dhe kur përmbushen të gjitha kushtet, Pagesa e zakonshme e Invaliditetit shndërrohet automatikisht në pension pleqërie.

Shuma e Pagesës së Invaliditetit përcaktohet me sistemin e llogaritjes së përzier, i cili parashikon që një pjesë të llogaritet me sistemin e pagave dhe një pjesë me sistemin kontributiv ose, në qoftë se punonjësi ka filluar veprimtarinë e punës mbas datës 31 dhjetor 1995, me sistemin kontributiv.

Pagesa është e vlefshme për tre vjet, por mund të rinovohet me kërkesë të palës së interesuar.

Mund ta kërkojë ndihmën kushdo që, për shkak të sëmundjes apo defektit fizik ose mendor, ka një aftësi pune të reduktuar në më pak se një të tretën dhe që ka grumbulluar **të paktën pesë vjet sigurime** dhe 260 kontribute javore (pesë vjet që ka derdhur kontribute) nga të cilat 156 (**tre vjet** që ka derdhur kontribute) në pesë vjetët përpara datës së paraqitjes së kërkesës.

Nuk kërkohet ndërprerja e veprimtarisë së punës.

E drejta për përfitim mund të përmbushet edhe me derdhjen e kontributeve të huaja të grumbulluara në vendet e Bashkimit Europian ose në vendet joanëtare të Bashkimit Europian, të cilat kanë marrëveshje me Italinë. Në këtë rast, e drejta e pensionit mund të përcaktohet duke i totalizuar ndërkombëtarisht periudhat e sigurimit italian dhe atij të huaj. Ndërsa masa e pensionit llogaritet në përpjesëtim me kontributet e derdhura në sigurimin italian, sipas kriterit të përpjesëtimit (pro-rata) që zbatohet për përfitimet në regjim ndërkombëtar.

Kërkesa mund të dorëzohet elektronikisht nëpërmjet shërbimeve online të Institutit Kombëtar të Mbrojtjes Shoqërore (INPS), nëpërmjet Qendrës së Kontaktit ose nëpërmjet patronateve dhe ndërmjetësve të autorizuar.

Pension I paaftësisë për punë për të regjistruarit në fondin e punonjësve publikë (Pensione di inabilità per gli iscritti alla gestione dipendenti pubblici)

Në kuadrin e harmonizimit midis sistemeve të ndryshme të pensioneve, hyrja në fuqi e Ligjit nr. 335/95, e ka shtrirë rregulloren e parashikuar sipas Ligjit nr. 222, të datës 12/6/84, edhe në sektorin e punësimit publik, duke përfshirë "paaftësinë absolute dhe të përhershme për çdo veprimtari pune", në përputhje me dispozitat e nenit 2, paragrafi 12.

Pensioni i paaftësisë për punë për punonjësit e sektorit publik mund të kërkohet nga të gjithë punonjësit publikë që janë të regjistruar në skemat ekskluzive të pensioneve të Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm (AGO).

Duke filluar nga viti 2013, pensioni në fjalë paguhet duke marrë parasysh të gjithë kontributin e derdhur nga punonjësi në Sigurimin e Përgjithshëm të Detyrueshëm (AGO), si edhe në skemat zëvendësuese, përveç Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm dhe në Fondin e Veçantë të Sigurimit.

Pensioni i paaftësisë fillon nga dita pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Nëse kërkesa paraqitet nga personi që trajtohet me një pension të zakonshëm invaliditeti brenda dy vjetëve nga përfundimi i marrëdhënies së punës, pensioni fillon që nga dita e parë e muajit mbas paraqitjes së kërkesës.

Përfitimi është i vlefshëm për gjithë jetën dhe, për këtë arsye, ndërpritet me vdekjen e pensionistit. Gjithashtu mund të kalojë në favor të të pasjetuarve që e kanë këtë të drejtë.

E drejta për pension paaftësie takon të merret kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

1. zotërimi i një vjetërsie kontributive prej pesë vjetësh, nga të cilat të paktën tre në periudhën pesëvjeçare përpara fillimit të pensionit;
2. përfundimi i marrëdhënies së punës për shkak të paaftësisë që nuk varet nga shkaqe të lidhura me shërbimin;
3. njohja e gjendjes së paaftësisë absolute dhe të përhershme për të kryer çfarëdolloj veprimtarie pune që është shkaktuar nga një paaftësi që nuk varet nga shkaqe që lidhen me shërbimin.

Njohja e një pensioni të paaftësisë përfshin një derdhje kontributesh konvencionale vjetërsie deri në moshën 60 vjeç, brenda kufirit të vitit të 40-të të shërbimit, të dobishme për të gjitha efektet e llogaritjes së pensionit.

Pensioni i paaftësisë absolute dhe të përhershme për çdo veprimtari pune është i papajtueshëm me kryerjen e një pune si punonjës i punësuar apo i vetëpunësuar, të kryer në Itali ose jashtë vendit dhe shfuqizohet në rast se konstatohet një kontribut që është i lidhur me veprimtarinë e punës, të vetëpunësuar ose në vartësi, i cili rezulton të jetë derdhur në afatin kohor mbas fillimit të pensionit.

Gjithashtu, është i papajtueshëm me regjistrimin në regjistrat e të dhënave të punëtorëve të bujqësisë ose me regjistrimin në regjistrat e emrave të punonjësve të vetëpunësuar ose në regjistrat profesionalë dhe me përfitimet e paguara nga sigurimi i detyrueshëm i papunësisë dhe me çdo trajtim tjetër që zëvendëson ose plotëson shpërblimin.

Për të kërkuar pensionin e paaftësisë, të rregulluar nga neni 2, paragrafi 12, i ligjit nr. 335, të datës 08 gusht 1995, është e nevojshme t'i paraqitet një kërkesë administratës pranë së cilës punonjësi ose ish-punonjësi kryen ose ka kryer veprimtari pune, duke përdorur formularin specifik që vihet në dispozicion.

Kërkesës së sipërpërmendur duhet t'i bashkëngjitet një certifikatë mjekësore që vërteton gjendjen e paaftësisë absolute dhe të përhershme për të kryer çdo veprimtari pune.

Administrata publike do të kujdeset për t'ia besuar verifikimin e gjendjes së paaftësisë për punë komisioneve mjekësore kompetente.

Pas marrjes së rezultateve të kontrolleve shëndetësore që vërtetojnë gjendjen e paaftësisë absolute dhe të përhershme për të kryer çfarëdolloj veprimtarie pune, punëdhënësi shpall vendimin e ndërprerjes së shërbimit për shkak të paaftësisë dhe ia dërgon të gjithë dokumentacionin përkatës, duke përfshirë edhe procesverbalin, Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Mbasi të jetë konstatuar paaftësia për punë nga ana e komisionit mjekësor kompetent, kërkesa për pension invaliditeti mund të paraqitet në Institutin Kombëtar të Mbrojtjes Shoqërore (INPS), ekskluzivisht në mënyrë elektronike.

Pension i zakonshëm paaftësie për punë (Pensione ordinaria di inabilità)

Bëhet fjalë për një përfitim pensioni që i jepet një punonjësi që nuk është më në gjendje të vazhdojë punën për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të tij. Pensioni fillon që nga dita mbas përfundimit të marrëdhënies së punës.

Për të përfituar paaftësinë për punë, është e nevojshme që të përmbushen kërkesat e mëposhtme:

1) njohja mjeko-ligjore, e hartuar nga Komisioni kompetent, në të cilën tregohet se punonjësi publik nuk është më i aftë të kryejë punë fitimprurëse në mënyrë të përhershme;

2) të ketë kryer të paktën 15 vjet shërbim;

3) përfundimi i marrëdhënies së punës si pasojë e përjashtimit nga shërbimi për shkak të paaftësisë.

Vizita mjekësore mund të kërkohet si nga punonjësi, ashtu edhe nga punëdhënësi. Mendimi i mjekëve shprehet nga Komisioni mjekësor kompetent. Mbasi të jetë marrë raporti i ekzaminimit mjekësor që njeh paaftësinë e zakonshme, punëdhënësi e përjashton punonjësin publik nga shërbimi për shkak të paaftësisë. I përjashtuar nga shërbimi, punonjësi duhet të paraqesë një kërkesë për një pension të zakonshëm paaftësie për punë në Institutin Kombëtar të Mbrojtjes Shoqërore (INPS).

Përfitimi përcaktohet në bazë të shërbimit të zotëruar në kohën e ndërprerjes së punës dhe fillon që nga dita mbas përjashtimit nga shërbimi. Gjithashtu, marrja e përfitimit është në përputhje me kryerjen e veprimtarive të punës.

Përfitimi është i vlefshëm për gjithë jetën dhe për këtë arsye ndërpritet me vdekjen e pensionistit. Gjithashtu mund të kalojë në favor të të pasjetuarve që e kanë këtë të drejtë.

Pensioni i privilegjuar (Pensione di privilegio)

Pensioni i privilegjuar është një përfitim pensioni i njohur pas sëmundjes ose lëndimit të pësuar për shkak të shërbimit.

Nuk kërkohet asnjë kusht për vjetërsinë kontributive.

Që nga data 06 dhjetor 2011, me nenin 6, të dekretligjit 201/2011, të konvertuar, me ndryshime, nga ligji 214/2011 ("reforma Monti-Fornero"), janë shfuqizuar institutet e verifikimit të varësisë së sëmundjes nga shkaqet që lidhen me shërbimin, të kompensimit të drejtë dhe të pensionit të privilegjuar për të gjithë punonjësit publikë, me përjashtim të personelit që i përket sektorit të sigurisë, mbrojtjes, zjarrfikësve dhe shpëtimit publik.

Kështu, vazhdon të ketë të drejtë për pension të privilegjuar personeli që u përket sektorëve të mëposhtëm:

• Forcat e Armatosura (Ushtria, Marina dhe Forcat Ajrore);

• Arma e Karabinierëve;

• Forcat e Policisë të sistemit civil (Policia e Shtetit dhe Policia e Burgjeve) dhe ushtarak (Policia Financiare);

• Trupa Kombëtare e Zjarrfikësve dhe Trupat e Shpëtimit Publik.

Në rast vdekjeje të përfituesit, pensioni i privilegjuar u takon të pasjetuarve.

Për personelin ushtarak ose për ata për të cilët zbatohen dispozitat e përcaktuara për ushtarakët, e drejta për pension të privilegjuar fitohet në përputhje me dispozitat e Nenit 67, të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 1092/1973.

Pensioni i privilegjuar mund të njihet edhe në rast se sëmundja/lëndimi i pësuar nga pala e interesuar nuk ka përcaktuar një paaftësi për shërbim, dhe kjo për shkak se neni i sipërpërmendur nuk parashikon aftësi për shërbimin.

Ushtaraku që pëson lëndime ose sëmundje që i atribuohen njërës prej kategorive të Tabelës A që i bashkëngjitet Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 915/1978 dhe ndryshimeve të mëpasme, pas ngjarjeve që rrjedhin nga përmbushja e detyrimeve të shërbimit, të cilat kanë qenë një faktor apo bashkëfaktor vendimtar dhe përcaktues, ka të drejtën:

• e pensionit, në qoftë se lëndimet ose dobësitë nuk japin shenja përmirësimi (Neni 67, Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 1092/1973);

• e një pagese të rinovueshme, në rast se lëndimet ose sëmundjet njihen si të përmirësueshme (Neni 68).

Ndërsa, në qoftë se sëmundjet ose lëndimet i atribuohen Tabelës B që i bashkëngjitet Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 915/1978 dhe ndryshimeve të mëpasme, ushtaraku ka të drejtë për një pagesë të vetme në përputhje me një ose më shumë vjet pensioni të kategorisë së tetë, me një maksimum prej pesë vjetësh, sipas nivelit të rëndesës së sëmundjes së konstatuar (Neni 69 i Tekstit Unik 1092/1973 dhe Neni 4, paragrafi 2, i Ligjit 9/1980).

Neni 67, paragrafi 2, i Tekstit Unik 1092/1973, parashikon se pensioni i privilegjuar është i barabartë me shumën e bazës së pensionit (100%) nëse sëmundja klasifikohet në

kategorinë e 1-rë, ose 90%, 80%, 70%, 60%, 50%, 40%, 30% nëse sëmundjet klasifikohen përkatësisht në kategoritë e 2-të, 3-të, 4-t, 5-të, 6-të, 7-të dhe 8-të.

Nëse punonjësi ka arritur vjetërsinë e kërkuar për të marrë pensionin e zakonshëm dhe të treguar në Nenin 52 të Tekstit Unik 1092/1973 (15 vjet shërbim), pensioni i privilegjuar paguhet në shumën e parashikuar për pensionin e zakonshëm, të rritur me 10% (Neni 67, paragrafi 4), nëse është më i favorshëm sesa shuma e parashikuar në paragrafin e dytë.

Në rast se sëmundjet klasifikohen në kategorinë e 7-të ose të 8-të, parashikohet një rritje prej 0.20% dhe 0.70% e bazës së pensionit, për çdo vit shërbimi të dobishëm në favor të atyre që kanë kryer të paktën pesë vjet shërbim efektiv, pa grumbulluar vjetërsinë e nevojshme për përfitimin e pensionit normal. Pensioni i privilegjuar në këtë rast nuk mund të kalojë 44%.

Pensioni familjar, për të pasjetuarit (Pensione ai superstiti)

Pensioni familjar është një trajtim me pension i njohur në rast vdekjeje së pensionistit (pensioni i të pasjetuarve) ose i personit të siguruar (pension jo i drejtpërdrejtë), i cili jepet në favor të anëtarëve të pasjetuar të familjes.

Pensioni familjar është i barabartë me një përqindje të pensionit të të ndjerit.

Pensioni jo i drejtpërdrejtë njihet nëse personi i siguruar ka derdhur 15 vjet sigurime dhe vjetërsi kontributive ose 5 vjet sigurime dhe vjetërsi kontributive, nga të cilat të paktën 3 vjet në periudhën pesëvjeçare që i paraprin datës së vdekjes.

Kanë të drejtën për trajtim me pension si të pasjetuar personat e mëposhtëm:

- bashkëshorti/-ja ose partneri civil. Bashkëshorti/-ja që martohet sërish humbet të drejtën për pensionin e të pasjetuarve. Po ky person ka të drejtë për një pagesë të njëhershme të barabartë me pagesën e dy vjetëve (neni 3 i dekretit legjislativ të datës 18 janar 1945, nr. 39) të shumës së pensionit që paguhet, duke përfshirë muajin e trembëdhjetë, në masën që i takon në datën e martesës së re (e ashtuquajtura shuma vjetore e dyfishtë);
- bashkëshorti/-ja i/e ndarë;
- bashkëshorti/bashkëshortja i/e divorcuar, me kusht që ai/ajo të ketë të drejtë për shpërblim divorci, të mos jetë martuar sërish dhe që data e fillimit të marrëdhënies së sigurimit të të ndjerit/-ës të jetë para datës së vendimit që shpall zgjidhjen ose ndërprerjen e efekteve civile të martesës

Në rast se i/e ndjeri/-a është martuar sërish mbas divorcit, pjesët që i takojnë bashkëshortit / bashkëshortes pasjetues/-e dhe bashkëshortit/bashkëshortes së divorcuar përcaktohen me një vendim nga Gjykata.

- Fëmijët dhe të birësuarit apo të njohur ligjërisht:
    - fëmijët e mitur në datën e vdekjes së të ndjerit/-ës;

- fëmijët e paaftë për punë dhe të varur nga prindi në kohën e vdekjes, pavarësisht nga mosha;
- fëmijët në moshë madhore që janë studentë, në ngarkim të prindit në kohën e vdekjes, të cilët nuk punojnë, që ndjekin shkolla ose kurse trajnimi profesional ekuivalente me kurset shkollore, deri në moshën 21 vjeç;
- fëmijët në moshë madhore që janë studentë, në ngarkim të prindit në kohën e vdekjes, të cilët nuk punojnë, që ndjekin, në kufijtë e kohëzgjatjes ligjore të kursit të studimit dhe jo më vonë se mosha 26 vjeç.

I pasjetuari konsiderohet të jetë në ngarkim të personit të siguruar ose të pensionistit të ndjerë, nëse ekzistojnë kushtet e mungesës së pavarësisë ekonomike dhe të mbajtjes së zakonshme ekonomike. Për përcaktimin e jetesës në ngarkim, një rëndësi të veçantë merr bashkëjetesa ose jo e të pasjetuarit me të ndjerin.

Fëmijët studentë kanë të drejtë e pensionit të të pasjetuarit edhe nëse kryejnë një veprimtari pune, nga e cila nxjerrin të ardhura të vogla. Kjo konsiderohet të jetë një e ardhur vjetore që nuk e tejkalon një shumë të barabartë me pensionin minimal vjetor të ofruar nga Fondi i Pensionit të Punonjësve, të rritur me 30%, i përshtatur me parametrat e periudhës në të cilën është kryer veprimtaria e punës.

• Në mungesë të bashkëshortit/-es dhe fëmijëve ose në qoftë se, edhe nëse ekzistojnë, nuk kanë të drejtën për të përfituar pensionin e të pasjetuarve, prindërit e personit të siguruar ose pensionistit që, në kohën e vdekjes së këtij të fundit, kanë mbushur moshën 65 vjeç, nuk marrin një pension të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe janë të varur nga punonjësi i ndjerë;

• Në mungesë të bashkëshortit/-es dhe fëmijëve ose në qoftë se, edhe nëse ekzistojnë, nuk kanë të drejtën për të përfituar pensionin e të pasjetuarve, vëllezërit dhe motrat e pamartuara të personit të siguruar ose pensionistit që në kohën e vdekjes së këtij të fundit nuk janë në gjendje të punojnë, nuk marrin një pension të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe janë të varur nga punonjësi i ndjerë.

Pensioni familjar është i barabartë me një përqindje të pensionit të paguar më përpara ose që do t'i kishte takuar të siguruarit të ndjerë.

Përqindjet e pagesës përcaktohen në masat e mëposhtme:

• vetëm bashkëshorti/-ja: 60%;

• bashkëshorti/-ja dhe një fëmijë: 80%;

• bashkëshorti/-ja dhe dy ose më shumë fëmijë: 100%.

Në qoftë se kanë të drejtë për pension vetëm fëmijët, apo prindërit ose vëllezërit ose motrat, përqindjet e pagesës janë si më poshtë:

• një fëmijë: 70%;

• dy fëmijë: 80%;

• tre ose më shumë fëmijë: 100%;

• një prind: 15%;

- dy prindër: 30%;
- një vëlla ose motër: 15%;
- dy vëllezër ose motra: 30%;
- tre vëllezër ose motra: 45%;
- katër vëllezër ose motra: 60%;
- pesë vëllezër ose motra: 75%;
- gjashtë vëllezër ose motra: 90%;
- shtatë ose më shumë vëllezër ose motra: 100%.

Shumat e pagesave të pensionit familjar për të pasjetuarit mund të grumbullohen me të ardhurat e përfituesit (bashkëshort/-e, prindër, vëllezër dhe motra), brenda kufijve të përcaktuar në Tabelën F, të Ligjit të datës 08 Gusht 1995, nr. 335.

Kufijtë e grumbullimit nuk zbatohen në rast se përfituesi është pjesë e një bërthame familjare me fëmijë të mitur, studentë ose persona me aftësi të kufizuara, të identifikuar sipas rregulloreve të Sigurimit të Përgjithshëm të Detyrueshëm.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 162/2022, ka vendosur që zbritja efektive e pensionit nuk mund të bëhet në një masë më të madhe se shuma e vetë të ardhurave.

Pensioni familjar për të pasjetuarit fillon nga dita e parë e muajit mbas vdekjes së pensionistit ose personit të siguruar.

Kërkesa për përfitimin e këtij pensioni mund të paraqitet nëpërmjet kanaleve elektronike që janë vënë në dispozicion nga Instituti (portali i Institutit Kombëtar të Mbrojtjes Shoqërore - INPS), nëpërmjet Qendrës së Kontaktit, ose duke përdorur mbështetjen e qendrave të patronateve dhe të ndërmjetësve të autorizuar.

Guida su Prestazione pensionistiche italiane 2025

Pensione di vecchiaia

La pensione di vecchiaia è una prestazione economica erogata, su domanda dell'interessato, in favore dei lavoratori che risultino in possesso dei requisiti anagrafici e contributivi stabiliti dalla normativa vigente. Tale trattamento è rivolto ai soggetti iscritti all'Assicurazione Generale Obbligatoria (inclusi i dipendenti del settore privato e le gestioni speciali per lavoratori autonomi quali artigiani, commercianti, coltivatori diretti, mezzadri e coloni), alla Gestione Separata, nonché ai lavoratori aderenti a forme pensionistiche sostitutive o esclusive dell'AGO.

La **decorrenza** del trattamento pensionistico varia in funzione della gestione di appartenenza.

Per i **lavoratori dipendenti e autonomi** iscritti all'AGO, nonché per gli iscritti alla Gestione Separata, la pensione di vecchiaia decorre dal primo giorno del mese successivo al perfezionamento dei requisiti richiesti ovvero, su istanza dell'interessato, dal mese successivo alla presentazione della domanda.

Per i **dipendenti pubblici** iscritti alle forme esclusive dell'AGO, la pensione decorre dal giorno successivo alla cessazione del rapporto di lavoro. Per il personale scolastico e per quello dell'Alta Formazione Artistica, Musicale e Coreutica (AFAM), la decorrenza è fissata rispettivamente al primo settembre e al primo novembre dell'anno in cui risultano perfezionati i requisiti.

I **requisiti** per l'accesso al trattamento differiscono a seconda della collocazione temporale dei contributi maturati dall'assicurato. I soggetti in possesso di contribuzione antecedente al 1 gennaio 1996 rientrano nel **sistema di calcolo misto** e accedono alla pensione con almeno **67** anni di **età** (requisito da adeguare alla speranza di vita a partire dal 2027) e **20** anni di contribuzione utile.

I lavoratori la cui contribuzione decorre esclusivamente dal 1° gennaio 1996, soggetti al **regime contributivo puro**, possono accedere alla pensione di vecchiaia al compimento dei 67 anni di età e con almeno 20 anni di contribuzione, a condizione che l'importo maturato risulti pari o superiore all'assegno sociale (cd. importo soglia). In alternativa, è riconosciuta la facoltà di conseguire il diritto a pensione al raggiungimento dei 71 anni di età (con eventuale adeguamento alla speranza di vita dal 2027), in presenza di almeno cinque anni di contribuzione effettiva, indipendentemente dall'importo maturato.

Ai fini del riconoscimento del diritto alla pensione di vecchiaia, è necessario che l'assicurato abbia cessato il rapporto di lavoro dipendente. Non è invece richiesta la cessazione dell'attività per coloro che operano in qualità di lavoratori autonomi o parasubordinati.

